

Nr. 921/prot.  
7

Tiranë, më 30.03.2022

**VENDIM**

**Nr. 28 , datë 30.03.2022**

**“PËR MIRATIMIN E PËRFITIMIT TË BURSËS SIPAS KRITERIT EKONOMIK,  
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022, PËR STUDENTEN RONILDA TAFI, QË  
STUDION NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË, NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 513/6 datë 29.03.2022 “Mbi miratimin e kërkesës së një studenti për përfitim burse sipas kriterit ekonomik për vitin akademik 2021-2022”, në mbledhjen e datës 30.03.2022,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përfitimin e bursës sipas kriterit ekonomik, për vitin akademik 2021-2022, për studenten Ronilda Tafi, që studion në një program studimi të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETAR  
ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË**

**MONIKA FIDA**

**ALBANA GJINOPULLI**

**VERA OSTRENI**

**ANIS THODHORJANI**

**ALTINA XHAFERI**

**ENDRIT YZEIRAJ**